

Në bazë të nenit 172 të Ligjit për Arsimin e Lartë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/2018“), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, shpallet

## **KONKURS**

për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në Universitetin e Tetovës

Shpallet Konkurs për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në Universitetin e Tetovës:

### **FAKULTETI FILOZOFIK**

1. Një mësimdhënës në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin Psikologjia e këshillimit, Psikologjia e arsimimit dhe edukimit (51003, 51005 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

### **FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE**

1. Një mësimdhënës në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin Bioteknologji, Të tjera (30608, 30616 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).
2. Një mësimdhënës në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin Bioteknologji, Farmaci sociale, Të tjera (30608, 30615, 30616 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).
3. Një mësimdhënës në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore në lëmin Higjienë, Kujdes shëndetësor, Edukim shëndetësor me metodologji (30500, 30501, 30502 nga klasifikimi i sferave, fushave dhe lëmenjve shkencorë-hulumtues sipas Klasifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit).

### **Kushtet për thirrjen mësimore-shkencore docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar:**

- Thirrje mësimore – shkencore, me Vendim të organit kompetent, nëse e posedon;
- Diplomë për gradën shkencore doktor i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet;
- Kandidatët që konkurrojnë duhet të kenë kontinuitet në studimet nga fusha përkatëse;
- Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara, si dhe kopje të punimeve të publikuara;
- Biografi e shkurtër;
- Ta dorëzojë punimin e doktoratës;
- Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj;
- Njohje të gjuhës shqipe - shkrim dhe lexim;
- Certifikatë nga libri amë i të lindurve;
- Certifikatë e shtetësisë.

\*Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, të parapara me nenin 166 të Ligjit për arsimin e lartë.

\*Fletëparaqtjen bashkë me dokumentet e nevojshme, kandidati duhet t'i dorëzojë në afat prej 5 ditë pune, nga dita e shpalljes së Konkursit, në Rektoratin e Universitetit të Tetovës, në adresën: Rektorati i Universitetit të Tetovës, Rr. e Ilindenit, p.n. Tetovë.

**Universiteti i Tetovës**